V E N D I M
Nr.346, datë 26.6.1995

PËR NJË SHTESË NË UDHËZIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.10, DATË 17.8.1993 "PËR PROKURIMIN ME FONDE SHTETËRORE NË PROJEKTIMIN DHE ZBATIMIN E NDËRTIMEVE PUBLIKE"

Me propozimin e Ministrisë së Bujqësisë dhe të Ushqimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në udhëzimin e Këshillit të Ministrave nr.10, datë 17.8.1993, në kreun IV "Sipërmarrja" shtohet pika 10 me këtë përmbajtje:

"Për rehabilitimin e veprave ujitëse e kullimit, mbrojtjes nga gërryerjet dhe veprave në vazhdim me vlerëderi në 5 milionë lekë prokurimi do të kryhet:

a)Me ankand të drejtpërdrejtë me drejtoritë e ujërave të rretheve përkatëse.

b)Me ankand të kufizuar me pjesëmarrje të subjekteve vendase, zgjedhja e të cilave bëhet ndërmjet jo më pak se tri ofertave të apraqitura, pranimi i të cilave bëhet jo më pak se 10 ditë nga data e njoftimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet nga data 1 janar 1995.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi